



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI I POLICISË KRIMINALE

Nr. 133 Prot.

Kopje 02
Tiranë, më 01.02.2024

AUTORIZIM

Për Ekzekutimin e Vendimit nr 46 të Sekuestros datë 22.01.2024 te Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë Për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Departamenti i Policisë Kriminale, Sektori për Hetimin e Korrupsionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, autorizon **Kryekomisar Sander Ndoj**, me detyrë specialist në Sektorin për Hetimin e Korrupsionit, për të bërë ekzekutimin e vendimit nr 46 datë 22.01.2024 te Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë Për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Duke ju falenderuar për bashkpunimin.

DREJTORI

Drejtues i Lartë **Neritan NALLBATI**
NË MUNGESË E MË AUTORIZIM
Drejtues i Parë **Edmond RIZAD**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

URDHËR

Për ekzekutimin e vendimit për sekuestron preventive

Në Tiranë viti 2024, muaji Janar data 31, ne Edvin Kondili dhe Ened Nakuçi me detyrë prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar pasi u njohëm me aktet e procedimit penal nr.13 të vitit 2021, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar,

KONSTATUAM

Se në datë 13.01.2020, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ka regjistruar procedimin penal nr.13 të vitit 2020 që bën fjalë për veprat penale të "Shpërdorimi i detyrës" në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248-25 i Kodit Penal, "Shkelja e barazisë së pjesëmarrëve në tendera apo ankande publike" në bashkëpunim, parashikuar nga neni 258-25 i Kodit Penal, "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetëror ose i të zgjedhurve vendorë" parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal, në lidhje me procedurën e dhënies me koncension "Për shërbime të integruara për ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, furnizimin me material mjeksor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale si dhe trajtimin e mbetjeve biologjike dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale", nga Ministria e Shëndetësisë.

Pas regjistrimit të procedimit penal nga ana e policisë gjyqësore janë kryer një numër jashtëzakonisht i madhe veprimesh hetimore në përfundim të të cilave me vendimin nr.46 akti datë 22.01.2024, të Gjykatës së Posaçme për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar ka vendosur si më poshtë vijojnë:

1. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.
2. Caktimin e masës së sigurimit pasuror, sekuestro preventive mbi këto pasuri:
 1. Pjesa takuese prej 40% e Shoqërisë SaniService Sh.P.K., me NIPT L51910021C, konkretisht kuota që i përket subjektit tregtar Investital Llc, në zbatim të kontratës "Për bashkimin e përkohshëm të shoqërive", nr.598 rep., dhe nr.287 kol., datë 04.03.2015, e lidhur midis 1)Investital Llc, me përfaqësues z.Illir Rrapaj ; 2)Servizi Italia SPA, me përfaqësues z.Enea Righi; 3)Tecnosanimed srl., me përfaqësues Umbro Staccini; 4) U.Jet Srl., me përfaqësues z.Umbro Staccini .
 2. Subjektin tregtar "Investital Llc", Investital Llc, shoqëri e së drejtës kosovare, regjistruar pranë Agjencisë së Regjistrimit të Biznesve në Kosovë, me numër fiscal 60113807, me administrator të vetëpersonin nën hetim Ilir Rrapaj;
 3. Shoqërinë tregtare shqipëtare "Globalsher" sh.p.k. me NUIS L62120029D, datë rregjistrimi 20.09.2016 dhe asetet e saj, me ortak të vetëm personin nën hetim Ilir Rrapaj.
3. Ngarkohet Prokurora e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, në bashkëpunim me hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, hetuesit e Seksionit Financiar, të mbështetur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për ekzekutimin e këtij vendimi.
4. Për administrimin e pasurive sipas pikës 2 të dispozitivit të këtij vendimi ngarkohet Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi brenda 10 (dhjetë) ditëve në Gjykatën e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nga e nesërmyja e njoftimit të këtij vendimi prokurorisë ose nga dita që i interesuari ka marrë dijeni për sekuestron e vënë.

Sa më sipër, është e nevojshme vënia në ekzekutim të vendimdhjetit të mësipërm.

Për ekzekutimin e këtij vendimi urdhërohen Hetuesit e Sektorit Financiar z.Gentian Keshi dhe z.Gerti Loli, në bashkëpunim me Oficerët e Policisë Gjyqësore të Sektorit për Hetimin e Krimin Ekonomik në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara.

Asetet dhe pasuritë e sekuestruara të administrohen nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara.


Sa më sipër në bazë të nenit 466 të K.Pr.Penale si dhe në vendimin e mësipërm të gjykatës,

URDHËROJMË:

1. Ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit penal nr.46 Akti datë 22.01.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë.
2. Për ekzekutimin e këtij vendimi urdhërohen Hetuesit e Sektorit Financiar z.Gentian Keshi dhe z.Gerti Loli, në bashkëpunim me Oficerët e Policisë Gjyqësore të Sektorit për Hetimin e Krimin Ekonomik në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara.
3. Asetet dhe pasuritë e sekuestruara të administrohen nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara.
4. Veprimet për ekzekutimin e këtij vendimi, të dokumentohen me procesverbalet përkatëse, të cilat të vihen në dispozicion të prokurorëve të çështjes.

PROKURORËT

Edvin Kondili



Ened Nakuçi

